



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Relacion

*PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.57
DT.28.12.2015 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
BASHKINË BERAT" I NDRYSHUAR*

Të nderuar këshilltarë!

Projekt vendimi - Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.57 dt.28.12.2015 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat" ju propozohet për miratim mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.3 germa b, neni 35 pika 5, neni 54 germa f, neni 64 germa c.
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në R.SH", të ndryshuar.

Për vitin 2018 do të aplikohet paketa fiskale e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.57 dt.28.12.2015 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat" të ndryshuar, por me ndryshime që propozojmë më poshtë.

Theksojmë se efektet në të ardhura të këtyre ndryshimeve janë paraqitur në planifikimin e të ardhurave.

Paketa është një e vetme, ku ka kategorizime të taksës/tarifës sipas llojit si dhe nivele të përcaktuara sipas çdo njësie administrative.

Gjithashtu janë unifikuar procedurat fiskale për çdo njësi administrative sipas procedurave që ndjek Bashkia Berat.

Më konkretisht në këtë projekt vendim janë paraqitur :

A. Ndryshime në pikat e paraqitura si më poshtë vijon :

Në pikën **II.TARIFAT VENDORE**, në pikat e poshtë përmendura :

4.TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Në pjesën "Sqarime" të tabelës, te pika

- Rrugët dhe sheshet ku do të shtrihet parkimi me pagesë janë, paragrafi i katërt ndryshon :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- Është :

Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti banka “Raiffeisen” – rruga “Fan Noli”).

Bëhet :

- Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti shkolla “Babë Dudë Karbunara” – rruga “Fan Noli”).

4.TARIFA E ZËNIE SË HAPSIRËS PUBLIKE

- Në pjesën “**Sqarime**” të tabelës ,paragrafi ndryshon :

- Është :

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë dhe vjeshtë (9 muaj/vit).

Bëhet :

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë, vjeshtë,dimër (12 muaj/vit).

- **Ne piken 11. “TARIFA TË TJERA TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE” te hiqet kategoria VII. “Tarifa të ujit”**

Duke ju ftuar që të votoni projekt-vendimin e paraqitur, ju falenderoj për bashkëpunimin tuaj!

DREJTORE E TAKSAVE DHE TREGJEVE

 Nevila ÇAUSHLLARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PROJEKT – VENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.57
DATË 28.12.2015 “PER SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË BASHKINË BERAT” I NDRYSHUAR**

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tregjeve , mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 9, neni 35, neni 54 , neni 64 /c; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

PROPOZON:

1. Në VKB nr.57 date 28.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat” i ndryshuar, të bëhen ndryshime në pikat e paraqitura si më poshtë vijon :

➤ Në pikën **II.TARIFAT VENDORE**, në kategorinë :

4.TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Në pjesën “**Sqarime**” të tabelës , në piken

- Rugët dhe sheshet ku do të shtrihet parkimi me pagesë janë , paragrafi :
-Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti banka “Raiffeisen” – rruga “Fan Noli”).

Ndryshohet me këtë përmbajtje :

- Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti shkolla “Babe Dude Karbunara” – rruga “Fan Noli”).

4. “TARIFA E ZËNIE SË HAPSIRËS PUBLIKE”

Në pjesën “**Sqarime**” të tabelës , paragrafi:

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë dhe vjeshtë (9 muaj/vit).

Ndryshohet me këtë përmbajtje :

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë, vjeshtë,dimër (12 muaj/vit).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

➤ Ne piken 11. "TARIFA TË TJERA TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE" të
hiqet kategoria VII. "Tarifa të ujit"

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe
Tregjeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Transportit,
Emergjencave dhe Shërbimeve, si dhe Policia Bashkiake .

KRYETARI I BASHKISË

Petrit SINAJ

Projekt- vendimi u pa dhe ka bazueshmëri ligjore .

Juriste

Nertila KADËNA

Sekretare e Keshillit Bashkiak

Ledina GJOROVENI